




Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 63 paragrafi 63.1.3 pika (a) lidhur me paragrafin 63.1.2 të Rregullores 01/2022 për Prokurimit Publik, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 19.04.2023 të paraqitur nga Operatori Ekonomik “Arhiko.Ing” O.P. nga Prishtina, bie këtë :

VENDIM

I

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “Arhiko.Ing” O.P. nga Prishtina e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 19.04.2023 për aktivitetin e prokurimit me numër: 626-23-1710-2-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-23-005-2-2-1 me titull: “HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE EKZEKUTIVE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITET 2023-2026”

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “Arhiko.Ing” O.P. nga Prishtina me datën 19.04.2023 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për anulim të procedurës nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: “HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE EKZEKUTIVE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITET 2023-2026”

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë i kemi paraparë kërkesat të cilat duhet ti plotësojnë Operatorët Ekonomik për të qenë të përgjegjshëm, andaj vlerësimi është bërë në bazë të legjislacionit të LPP-s si dhe në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1; 7; 52; 56; 57; 59; 60; 64; 65; 66 dhe 69 të LPP-s si dhe neni 10 i Udhëzuesit të Prokurimit Publik nr. 001/2023. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s dhe udhëzuesit, janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim.

Pretendimi i O.E. që kriteri i përzgjedhjes për shpërblimin me kontratë për pikën nr. 5.5 Lloji i Kontratës, Kërkesat dhe Kushtet e Dërgesës, Kushtet e Kontratës siç e kemi paraparë ne pasi që kjo kërkesë plotësohet pas nënshkrimit të kontratës meqë edhe kërkesa që është përpiluar në dosjen e tenderit nuk i përket kërkesave të pranueshmeria e OE apo kërkesat e përshtatshmërisë në dosjen e tenderit, kërkesa këto që sipas O.E. ankues i janë përmbajt dhe i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga ana AK-s të cilat përcaktohen sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi, nuk qëndron.

Operatori Ekonomik në pretendimin në fjalë i ngatërron kushtet e pjesëmarrjes për të qenë i përgjegjshëm një O.E. me kriterin e dhënies së kontratës.

Duhet të sqarohet që kriteri i dhënies së kontratës është përcaktuar në nenin 60 të LPP-së dhe me rastin e shpalljes së njoftimit për kontratë, është përcaktuar shumë qartë në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë i cili ka qenë “Tenderit i përgjegjshëm me çminimin më të ulët sipas poentimit” Ndërsa kërkesat e pranueshmërisë dhe të kualifikimit janë kërkesa të cilat i përcakton Autoriteti Kontraktues për tu konsideruar një Operator Ekonomik si i përgjegjshëm për t’u shpërblyer me kontratë.

Në nenin 40.6 të Rregullorës 001/2022 për Prokurimin Publik është paraparë që:

Citat “Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;
- b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;
- c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.”

Kërkesa që Operatorët Ekonomik të dorëzojnë afatin e hartimit të projekteve i cili nuk duhet të jetë më i gjatë se njëzetë (20) ditë është kusht formal administrativ dhe kushtet e tilla janë të detyrueshme për Operatorët Ekonomik për tu konsideruar si të përgjegjshëm dhe për të cilat nuk mund të kërkohej sqarim sipas dispozitave të legjislacionit të prokurimit, por nëse nuk plotësohen atëherë tenderi duhet të refuzohet.

Në dosje të tenderit tek Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FDT) në nenin 5.5 dhe në njoftimin për kontratë në nenin III pika III.1.3 është paraqitur kushti si vijon:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë afatin për kryerjen e hartimit të projekteve ideore dhe ekzekutive sipas specifikave teknike të kërkuara në dosjen e tenderit.

Afati i hartimit të projekteve ideore dhe ekzekutive nuk duhet të jetë më i gjatë se njëzetë (20) ditë nga data e marrjes së kërkesës nga Autoriteti Kontraktues.

Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do të refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.

Pra sikur shihet më lartë kërkesa ka qenë e qartë, sepse i është bërë me dije Operatorëve Ekonomik që kushti në fjalë është i detyrueshëm për O.E. pjesëmarrës. Gjithashtu pretendimi i O.E. ankues se ky kusht vlen pasi të jetë nënshkruar kontrata është i pa bazë, pasi që është theksuar qartë se oferta do të refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e O.E. Pra po bëhet fjalë për fazën e vlerësimit pasi që pas dhënies së kontratës nuk mund të eliminohet një operator ekonomik.

Pretendimi i O.E. ankues se kërkesa, sipas ligjit në fuqi është dashur të parashihet te kërkesat e pranueshmërisë apo kërkesat e përshtatshmërisë në dosjen e tenderit është e pa bazë sepse sikur sqaruam më lartë, nuk janë vetëm këto kërkesa për t’u cilësuar si i përgjegjshëm një O.E. por duhet të plotësohen edhe kërkesat formale administrative të parapara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë në nenin 16.1 është paraparë afati për sqarimin e tenderit i cili ka qenë deri me datën 21.03.2023 ora 14:00 në mënyrë që O.E. të kërkojnë sqarim në lidhje kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit, mirëpo ne nuk kemi pranuar ndonjë kërkesë për sqarimin e tenderit nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës. Andaj ata janë pajtuar që të tenderojnë me kërkesat dhe kriteret e parashtruara nga ne si Autoritet Kontraktues dhe për këtë nuk ka pasur ndonjë vërejtje.

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, konsiderojmë që pretendimet e O.E. sa i përket kësaj pike janë të pa baza.

Më tej Operatori Ekonomik ankues ka paraqitur pretendimin tjetër që ka hasur në disa parregullsi që janë lëshuar nga komisioni vlerësues në këtë procedurë tenderimi, duke pretenduar që sigurimi i tenderit të dorëzuar me ofertë është i ndryshëm nga ai i dorëzuar fizikisht pas kërkesës së Autoritetit Kontraktues për dorëzimin e origjinalit të sigurimit.

Pasi kemi pranuar njoftimin e O.E. ankues se sigurimi i skanuar që është dorëzuar me dosje të tenderit dhe sigurimi origjinal i dorëzuar nga O.E. i rekomanduar janë të ndryshëm, ne kemi kërkuar sqarim me shkrim nga kompania e sigurimeve “Elsig” e cila e ka lëshuar policën e sigurimit me nr. 111814 në mënyrë që të na sqaron se si ka ndodhur që polica e sigurimit të lëshohet me nr. të njëjtë dhe të dhëna të njëjta, ndërsa nënshkrimi në policën e dorëzuar fizikisht, është i ndryshëm nga ai i skanuar dhe i dorëzuar me ofertën e grupit të O.E. të rekomanduar për kontratë.

Me datën 20.04.2023 kemi pranuar përgjigjen nga kompania e sigurimeve “Elsig” se: Sigurimi i garancisë së tenderit me nr. 111814 është lëshuar nga K.S. “Elsig” sh.a. dhe e njëjta ka shumë sigurimi 1,000.00€ dhe se ky garancion ka mbulesë siguruese nga dt. 30.03.2023 deri me datën 28.06.2023. Andaj konsiderojmë që sigurimi i tenderit i plotëson kushtet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe sipas formës standarde e cila është pjesë e dosjes së tenderit, sepse i përmban të gjitha elementet. Ndërsa pretendimi që është shkelur neni 10 i Udhëzuesit të Prokurimit nr. 01/2023 është i pa bazë pasi që polica e sigurimit i përmban të gjitha pjesët e kërkuara në aneksin nr. 4 të dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimit dhe dyshimit të Operatorit Ekonomik ankues që Gr. i O.E. i rekomanduar nuk i kanë përmbushur kërkesat në pikat 9.1 dhe 9.2 duke ofruar gjithsejtë stafin e kompletuar sikur është kërkuar nga AK, sqarojmë që komisioni vlerësues e ka kryer vlerësimin në mënyrë profesionale duke e respektuar me përpikëri legjislacionin e prokurimit dhe pasi ka konstatuar që gr. i O.E. të rekomanduar i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, ka rekomanduar për dhënie të kontratës dhe ne si zyre e prokurimit, pasi kemi konfirmuar të dhënat, kemi aprovuar rekomandimin dhe kemi vendosur që të shpërblejmë me kontratë Grupi e O. E . “Gjeo Group” Sh.P.K. dhe “Enggroup” Sh.P.K.

Sa i përket dëmeve materiale dhe dëmit të konkurrencës, konsiderojmë se edhe ky pretendim është i pa bazë, pasi që duke u bazuar në legjislacionin e prokurimit, në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, janë plotësuar kushtet për të vendosur që O.E. ankues t’i refuzohet tenderi si i pa përgjegjshëm në përshtatje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 25.04.2023

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
Komuna Mamushë



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.